



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA

---

**Njësia e Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillin të Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës**

**Datë:06/04/2022  
KP/001/2022**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës/Njësia e Burimeve Njerëzore në pajtim me dispozitat e paragrafit 7 të nenit 10 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, me datë 06.04.2022 publikon këtë:

**SHPALLJE PUBLIKE**

***për pranimin e propozimeve nga organizatat e specializuara  
për ekspert të jashtëm të Komisionit të Pranimit***

Organizatat e specializuara-ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-të dhe/apo kompanitë e regjistruara në Republikën e Kosovës në fushën e burimeve njerëzore kanë të drejtë që të dërgojnë propozimet e tyre për ekspert të jashtëm/anëtar të Komisionit të Pranimit në Këshillin e Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

**Kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pranimit (ekspertët e jashtëm) të propozuar nga organizatat e specializuara, në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 10 ndërlidhur me paragrafin 2 të nenit 9 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, duhet t'i plotësojnë kriteret si në vijim:**

1. të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendi nevojitet nostrifikimi.
2. të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
3. të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
4. të kenë integritet moral dhe profesional;
5. të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;
6. të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

**Për kandidatët e propozuar nga organizatat e specializuara, duhet të dorëzohen dokumentet në vijim:**

- Biografinë (CV-në);
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për diplomat e pranuar jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale në pozitë e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga gjykata kompetente;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës.

**Organizatat e specializuara duhet të dërgojnë dëshminë zyrtare me të cilën dëshmojnë përmbushjen e kriterëve për statusin e organizatës së specializuar (ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-së dhe/apo kompanisë së regjistruar në Republikën e Kosovës) në fushën e burimeve njerëzore, si dhe duhet të ofrojnë të dhënat e sakta për adresën dhe numrin e telefonit kontaktues.**

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë të gjitha organizatat e specializuara që i plotësojnë kriteret e shpalljes të dërgojnë propozimet e tyre për anëtar të Komisionit të Pranimit në Këshillin e Pavarura Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kandidatët e përzgjedhur për anëtar të Komisionit të Pranimit është ad-hoc.

Anëtari i Komisionit si ekspert i jashtëm në Komisionin e Pranimit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për çdo procedurë konkurrimi në të cilën merr pjesë, në pajtim me dispozitat e nenit 11 të Rregullores (QRK) Nr.01/2022 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

**Afati për dorëzimin e propozimeve për ekspert të jashtëm në Komisionin e Pranimit, është i hapur nga data 06/04/2022 deri më datë 12/04/2022.**

Organizatat e specializuara të gjitha propozimet e tyre me dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në e-mail adresën: [bukurije.burjani@rks-gov.net](mailto:bukurije.burjani@rks-gov.net).

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin e telefonit: 038 200 10/459 ose në e-mail adresën: [bukurijeburjani@rks-gov.net](mailto:bukurijeburjani@rks-gov.net).

Ju faleminderit!